

*Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Konrad Adenauer dhe Institutit për demokraci “Societas Civilis” - Shkup*

# IMPRESUM

**Titulli: Garë në 3, 6 dhe 9 me pengesa. Drejt një rekomandimi të pastër?**  
Monitorim i implementimit të tre muajve të dytë nga Plani 3-6-9

**Botues:** Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë,  
Instituti për demokraci „Societas Civilis“ - Shkup

**Autor:** Zoran Nečev në bashkëpunim me Ivan Nikollovski

**Përkthyes:** Mustafa Peza

**Dizajn dhe përgaditje:** Vladimir Barlakoski

*Publikimi mund të shkarkohet falas në linkun në vijim:*

*<http://www.kas.de/mazedonien/>*

*<http://www.idscs.org.mk>*

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

341.171.071.51(4-672EY:497.7)

NEČEV, Zoran

Garë në 3, 6 dhe 9 me pengesa. Drejt një rekomandimi të pastër? [Електронски извор]  
: monitorim i implementimit të tre muajve të dytë nga Plani 3-6-9 / [Zoran Nečev]. -  
Shkup : Instituti për demokraci Societas Civilis, 2018

Начин на пристап (URL): <https://www.kas.de/mazedonien/>

Начин на пристап (URL): <https://www.idscs.org.mk>. - Текст во PDF формат, содржи 19  
стр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 02.03.2018. - Фусноти  
кон текстот. - Библиографија: стр. 18-19

ISBN 978-608-4775-37-9

а) Македонија - Препораки за зачленување - Европска унија

COBISS.MK-ID 106383626

# GARË NË 3, 6 DHE 9 ME PENGESA. DREJT NJË REKOMANDIMI TË PASTËR?

## Monitorim i implementimit të tre muajve të dytë nga Plani 3-6-9

*Zoran Neçev në bashkëpunim me Ivan Nikollovski*

### Presion i vazhdueshëm për reforma dhe implementimi i tyre

Në vigjilje të shpalljes së perspektivës së besueshme evropiane për zgjerim të vendeve nga Ballkani Perëndimor, Komisionari për politikë evropiane fqinjësore dhe negociata për zgjerim e theksoi intencën e Komisionit Evropian që pozitivisht ta vlerësojë avancimin e Maqedonisë dhe ta kthejë rekomandimin e pastër për fillimin e negociatave aderuese.<sup>1</sup> Në atë drejtim, është përmbushur një nga qëllimet kyçe të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë të vendosura me miratimin dhe zbatimin e Planit 3-6-9.

Efektuimi i rekomandimit nga Këshilli i UE prapëseprapë do të varet edhe nga sjellja e Maqedonisë në planin ndërkombëtar si dhe në bindjen e vendeve-anëtare të caktuara skeptike, para së gjithash të Holandës, Gjermanisë dhe të Francës, se shteti ka kapacitet dhe vullnet që ligjet dhe strategjitë e miratuara reformuese në kuadër të Planit t'i implementojnë në tërësi dhe në mënyrë të paanshme.

---

1 Svetlana Jovanovska, „Han për NOVA: Do t'i japim rekomandim të pastër Maqedonisë,“ Nova TV, shkurt 6,2018, <http://novatv.mk/han-za-nova-ke-i-dademe-chista-preporaka-na-makedonija/>.

Përcjellja e zbatimit të pjesës 6 nga plani 3-6-9 të Institutit për demokraci “Societas civilis”<sup>2</sup> zbulon se nga gjithsej 31 aktiviteteve të parapara, 16 aktivitete (52%) janë përbushur, 5 aktivitete (16%) janë përbushur pjesërisht, 6 aktivitete nuk janë përbushur (19%), ndërsa 4 aktivitete (13%) janë të pamatshme. Pjesa 6 ka të bëjë me periudhën nga zgjedhjet lokale deri në fund të vitit 2017. Krahasuar me pjesën 3<sup>3</sup>, përqindja e aktiviteteve të përbushura është në rritje e sipër prej 41% në 52%, njëllë siç është rritur edhe përqindja e aktiviteteve të pa përbushura prej 14% në 19%. Ndërkaq, përqindja e aktiviteteve pjesërisht të përbushura mbetet e njëjtë, përkatësisht 16%, shënojmë rënie në përqindjen e aktiviteteve të pamatshme prej 29% në 13%.

Vërehet përmirësim i Planit në drejtim të rritjes së shkallës së matjes dhe shkallës së parashikimit të tij. Moment tjetër pozitiv është që Qeveria, kësaj here, e publikoi planin në tërësi përkatësisht i publikoi aktivitetet të cilat duhet të ndërmerren gjatë tërë kohëzgjatjes së Planit 3-6-9. Gjithashtu, si pozitive vlerësohet edhe prioretizimi i bërë në raport me fushat reformuese. Për dallim nga plani paraparak, theksi është vënë në reformat në gjyqësi, shërbimet e sigurisë dhe të zbulimit si dhe në administratën publike.

Krahas këtyre momenteve pozitive, janë evidente edhe anomalitë të cilat përsëriten në këtë, si edhe në versionin paraparak të Planit. Përkatësisht, janë përfshirë masa që për nga natyra e vet janë aktivitete të vazhdueshme të institucioneve ose kompetenca e tyre për nga resori. Ato nuk janë dhe nuk mund të jenë një aktivitet reformues. Shembull i tillë është aktiviteti në fushën e Kuvendit e cila parashikon përkrahje aktive të grupeve multi-

---

2 Metodologjia e përcjelljes së zbatimit të masave është e qasshme në aneksin ndaj këtij raporti.

3 Zoran Neçev dhe Ivan Nikollovski, „Gara në 3, 6 dhe 9 me pengesa: Monitorim i zbatimit të tre muajve të parë nga Plani 3-6-9,” Instituti për demokraci „Societas civilis“ - Shkup, nëntor 2017.

partiake të interesit të deputetëve. Është logjike që ky aktivitet të zhvillohet në një periudhë më të gjatë, e jo në kornizë kohore prej 3 muaj dhe me këtë rast, nuk ka dyshim se e njëjta nuk paraqet aktivitet reformues. Të njëjtat vërejtje mund të theksohen për aktivitetin e titulluar “publikimi dhe azhurnimi i vazhdueshëm i regjistrit të organizatave civile në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione” – nga fusha “shoqëria civile”. Ky aktivitet nuk parashihet asgjë më shumë se sa zbatimi i Ligjit, gjë e cila në asnjë rast nuk mund të jetë një ndërhyrje reformuese. Më tej, raporti faktografik për pjesën 6 deri në momentin e përpilimit të këtij raporti nuk është publikuar, gjë e cila ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi transparencën e procesit dhe në informimit në kohë të opinionit për aktivitetet e realizuara të cilat qëndrojnë në Planin 3-6-9.

Sa i përket përqindjes së rekomandimeve të adresuara nga raporti i Pribesë nga viti 2015 dhe Prioritetet urgjente reformuese të Komisionit Evropian, aktivitetet në pjesën 6 e mbajnë të njëjtën përfshirje si në pjesën 3. Nga kjo rezulton se 8 aktivitete nga gjithsej 31 sa përmban plani për këtë periudhë kohore mund të ndërlidhen me këto dy raporte. E ngjashme është gjendja edhe me harmonizimin e masave në pjesën 6 me Programin kombëtar për miratimin e të drejtës së Unionit Evropian (PKMD 2016 - 2018) dhe aneksit të tij (2017 - 2020). Ndërkaq, në pjesën 3, 8 nga 73 masat (11% nga masat) burojnë dhe janë të harmonizuara me PKMD dhe/ose aneksin e tij, në pjesën 6 vetëm 3 nga 31 masat (10% nga masat) tregojnë harmonizim të tillë. Përmirësim i vogël, jo i konsiderueshëm prej 25% në 29% vërehet në adresimin e rekomandimeve nga raporti i dytë i Pribes të vitit 2017.

## Konteksti politik

---

Në këtë kontekst, me rëndësi është që të theksohet se Delegacioni i UE ka ndarë me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë listë të aktiviteteve prioritare të cilat do t'i mundësojnë Komisionit Evropian ta rekomandojë kthimin e rekomandimit të pastër.<sup>4</sup> Bëhet fjalë për dokument që është më i shkurtër se Plani 3-6-9 dhe përfshin aktivitete të ndërlidhura me fushat prioritare gjyqësi, shërbime të sigurimit dhe të zbulimit dhe administratën publike. Afati për zbatimin e aktiviteteve të kësaj liste prioritare në masë të madhe koincidon me pjesën 6 të Planit 3-6-9. Si rrjedhojë, një pjesë e aktiviteteve janë të inkorporuara në planin dhe në pajtim me njohuritë tona, një pjesë e madhe e atyre aktiviteteve tanimë janë të implementuara. Në pjesën e gjyqësisë, bëhet fjalë për përgatitje të raportit për keqpërdorimet e AKMIS sistemit i cili i është dorëzuar institucioneve kompetente. Më tej, është përgatitur Strategji për reforma në gjyqësinë, ndërsa janë miratuar edhe ndryshimet e Ligjit për Këshillin Gjyqësor me të cilat ky trup i fitoi kompetencat e Këshillit për përcaktimin e fakteve i cili u shlye. Në këtë pjesë, ka vonesë në miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për mbrojtje të dëshmitarëve. Në pjesën e administratës publike, është themeluar Këshilli për reforma të administratës publike, por ka vonesë në miratimin e Strategjisë së reformave të të njëjtës. Për në fund, në pjesën e sigurisë dhe të zbulimit, edhe pse jo plotësisht në frymën e rekomandimeve

---

4 360 Shkallë, “2018 - Sa është i rëndësishëm për Maqedoninë, aq suksesi eventual i Maqedonisë është me rëndësi edhe për Brukselin,” 360 Shkallë, 26-të dhjetor, 2017, [https://www.youtube.com/watch?v=\\_XOIsyc0Rds](https://www.youtube.com/watch?v=_XOIsyc0Rds).

të Pribesë,<sup>5</sup> është miratuar pakoja e ligjeve të sistemit të sigurisë-zbulimit, më saktë të sistemit për ndjekje të komunikimeve.

Në këtë pjesë të periudhës kohore e cila e mbulon planin 6, Kuvendi është i bojkotuar nga partia më e madhe opozitare. Përkatësisht, në periudhën prej momentit kur ata më 12 dhjetor e braktisën Kuvendin janë miratuar zgjidhje të caktuara prioritare ligjore si Ligji për ndërprerjen e vlefshmërisë së Ligjit për Këshillin për përcaktimin e fakteve dhe ngritje të procedurës për përcaktim të përgjegjësisë së gjykatësit dhe Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë; si dhe pakon e ligjeve në pjesën e sigurisë dhe të zbulimit janë në procedurë kuvendore ose janë miratuar (Ligji për ndjekje të komunikimeve; Ligji për Agjencionit operativ teknike (AOT); Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për komunikimet elektronike (i miratuar); Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurë penale; dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për informacionet e klasifikuara). Situata e tillë ndikon në mënyrë të konsiderueshme në zvogëlimin e kapaciteteve demokratike dhe në të njëjtën kohë del në shesh “pjekuria” e faktorëve politik dhe faktin se si ata e kuptojnë momentin kyç politik në raport me integrimin evropian.

---

5 Për shembull, në raportin e parë, Pribe e rekomandon transferimin e pajisjeve ndërmjetëse për përcjellje të komunikimeve te operatorët e komunikimit. Nga ana tjetër, pakoja e ligjeve reformuese në pjesën e sigurisë dhe të zbulimit, më konkretisht Propozim-Ligji për Agjencinë operative-teknike (AOT) parashikon transferim të pajisjeve ndërmjetëse në këtë organ të ri të pavarur shtetëror. Shih Grup ekspertësh. “Rekomandime të grupit të ekspertëve për çështjet sistemore të sundimit të të drejtës me përcjellje të komunikimeve të publikuar në pranverë të vitit 2015,” Komisioni Evropian, 8-të qershor, 2015, faqe 8.

# Vazhdimësia e planeve të publikuara

---

Për dallim nga versioni i parë i Planit, pjesa 6 është publikuar bashkë me pjesën 9<sup>6</sup> në të ashtuquajturin Plan 3-6-9+ duke e përfshirë kohëzgjatjen e tërësishme të planit në periudhën nga tetori i vitit 2017 deri në mars të vitit 2018 edhe më tej (prej këtu edhe plusi në emrin e planit). Në këtë format të ri hyjnë 59 aktivitete, nga të cilat 31 aktivitete hyjnë në kornizën kohore e cila e mbulon pjesën 6, ndërsa 26 aktivitete e përfshijnë pjesën 9. 2 aktivitete janë të vazhdueshme dhe dalin jashtë nga korniza kohore e planit.

Prej kësaj, krahasuar me atë paraprak, pjesa 6 ka më pak aktivitete nga pjesa 3 përkatësisht 31 në krahasim me 73. Zvogëlimi i numrit të aktiviteteve në këtë pjesë mund të shihet përmes perspektivës së krijimit të idesë për aktivitete qenësore dhe të mos ngarkimit të planit me të a.q. aktivitete të panevojshme nga lloji i formimit të grupeve të punës. Gjithashtu, është interesant të përmendet është fakti se pjesa 6, për dallim nga pjesa 3, dallohet në fushat prioritare dhe aktivitete të cilat i mbulon. Pa marrë parasysh se vërehet një shkallë e caktuar e vazhdimësisë në këtë kuptim, prapëseprapë disa fusha prioritare në masë të madhe janë të ndryshuara. Në disa raste aktivitete të cilat kanë filluar në pjesën 3 lihen anësh për llogari të atyre të reja në pjesën 6. Shembull i tillë janë aktivitete në pjesën e zgjedhjeve. Në këtë mënyrë, mbetet i paqartë rezultati i Raportit të OSBE/ODIHR në pjesën e raportimit të (pa)balancuar mediatik të procesit zgjedhor, të paraparë si kusht për shkarkimin e drejtorit të servisit publik radiodifuziv ose përgatitja e raportit të KSHZ për ankesat e parashtruara gjatë procesit zgjedhor në sajë të raportit për evaluim të procesit të sistemit të parashtresave. Kjo është

---

6 Pjesa 9 i përfshin tre muajt e parë të vitit 2018 – përkatësisht muajt, janar, shkurt dhe mars.



posaçërisht interesant duke e pasur parasysh se në muajin janar është shpallur konkurs për zgjedhje të drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të RTVM si dhe konkurs për zgjedhje të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës. Shembull i ngjashëm është edhe miratimi i akteve të nevojshme nënligjore në pajtim me rekomandimet e OSBE/ODIHR dhe të ekspertit të Komisionit të Venedikut.

Gjithashtu, ekzistojnë aktivitete, si ai i ndërlidhur me kontrollimin e funksionimit të AKMIS sistemit me konstatime të përcaktuara për keqpërdorime eventuale me rekomandime,<sup>7</sup> rezultati i të cilëve i mëtejme mbetet i paqartë dhe i pa sqaruar deri në fund. Në të vërtetë, edhe përkrah vazhdimësisë të këtij aktiviteti nga raporti paraprak, parashtrohet çështja se si rekomandimet dhe konstatimet e këtij raporti, i cili mes tjerash është i klasifikuar, për shkak të arsyeve të panjohura, do të klasifikohet për opinionin në praktikë. Askund në planin nuk ekziston informacion konkret se si do të procedojnë institucionet kompetente për gjetjet e këtij raporti. Kjo është me rëndësi të posaçme sepse depërton në thelbin e “shtetit të robëruar” dhe procesin e “lirimit”. Aq më tepër, është simptomatike që Këshilli gjyqësor, institucioni që q siguron dhe e garanton mëvetësinë dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor, vë në pah se Raporti për keqpërdorimet e AKMIS sistemit nuk përmban asgjë “të tmerrshme” dhe “pompoze”,<sup>8</sup> duke e fshehur me atë rast nën vellon e besueshmërisë e besueshmërisë së të njëjtit. Së këndejmi, ajo që gjithashtu mbetet e pa thënë deri në fund është te gjetjet e këtij raporti e këtilla.

7 Ministria e drejtësisë, „Fjala e Ministrit të drejtësisë, Bilen Saliji në pres - konferencën e sotme për funksionalitetin e sistemit informatik,“ Ministria e drejtësisë, 7-të dhjetor, 2017 [http://www.pravda.gov.mk/novost\\_detail.asp?lang=mak&id=1416](http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1416).

8 Elena Mukoska - Ivanovska, „Për Karaxhovskin nuk ka asgjë të tmerrshme në raportin për „Akmis-in“, „ Tellma/ Televizioni kombëtar, 15-ët shkurt, 2018, <http://telma.com.mk/za-karadhovski-nema-nishto-strashno-vo-izveshtajot-za-akmisot/>.

Më tej, fusha prioritare e dedikuar Marrëveshjes Kornizë të Ohrit nuk parashikon kurrfarë aktiviteti në pjesën 6 dhe është e përfaqësuar në formë të përpjekjes deklarative për avancimin e mëtejme të implementimit të zgjidhjeve të miratuara ligjore e cila paraqitet si hyrje në aktivitetin “Miratimi i Propozim-Ligjit për përdorim të ligjeve nga Qeveria, i cili mandej do ti dërgohet për konsultime Komisionit të Venedikut” të paraparë në pjesën 3. Pa marrë që vazhdimësia në kuptimin e përmbajtjes është i dukshëm, prapëseprapë ky aktivitet është i pamatshëm posaçërisht duke e pasur parasysh se nuk përmban aktivitete të cilat do ta operacionalizonin përpjekjen deklarative. Me rëndësi është të theksohet se gjatë miratimit të Propozim-ligjit për përdorim të gjuhëve nga Qeveria, i njëjti nuk është i dërguar për mendim Komisionit të Venedikut (Venecias). Në vend të kësaj, i njëjti i është dërguar Kuvendit për miratim të (në kushte kur opozita parlamentare është jashtë Kuvendit). Në të njëjtën kohë më zgjidhjen ligjore është vendosur flamuri evropian. Nëse në Qeverinë kanë konsideruar se bëhet fjalë për ligj me të cilin bëhet harmonizimi me legjislativin evropian, i njëjti duhet ti dërgohet Kuvendit me të gjitha dokumentet përcjellëse: deklarata e përputhshmërisë së projekt rregullores kombëtare me të drejtën e Bashkimit Evropian, si dhe tabelën koresponduese. Të njëjtat nuk i janë dorëzuar Kuvendit. Nëse Kuvendi dëshiron që në mënyrë thelbësore ta kryejë rolin e vet mbikëqyrës i njëjti duhet ta kthejë deri në përpunimin përfundimtar në Qeverinë dhe të mos shqyrtohet deri në dorëzimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme.

Kohabitimi i Qeverisë me Presidentin e shtetit si fushë tanimë nuk ekziston. Vetëm një nga aktivitetet nga plani 3 nga kjo fushë është e transferuar në formatin e ri të planit me afat i cili përputhet në pjesën 9 nga pjesa “Emërime”. E njëjta nuk është detajuar. Kohabitimi me Kryetarin e shtetit është me një rëndësi të madhe, posaçërisht në periudhën e ardhshme, që nuk është vetëm e ndërlidhur me vendet e zbrazëta në përfaqësitë

diplomatike-konsullore, por edhe në harmonizimin e dallimeve të ndërlidhura me Ligjin për gjuhët për të cilin Presidenti vuri veto dhe e ktheu Ligjin për votim të sërishëm, pas së cilës vijoi edhe bllokimi i punës së Kuvendit me parashtrimin e një numri të madh të amendamenteve nga ana e opozitës.

Në raport me vazhdimësinë e ndërlidhur me fushat prioritare, mund të konstatohet se aktivitete të caktuara që kanë qenë pjesë në planin e parë, në formatin e ri janë shpërndarë në tjetrën Duke e pasur parasysh se bëhet fjalë për aktivitete të njëjta përkatësisht shumë të ngjashëm shpërndarja e këtillë, pa sqarim përkatës, udhëzon në mungesën e klasifikimit përkatës dhe vizionit të masave dhe aplikimin e tyre në praktikë. I tillë është shembulli me masën aktiviteti i “përsosjes materialo-teknike të Qendrës kombëtare koordinuese për luftë kundër krimit të organizuar”. E njëjta masë e titulluar “operacionalizimi i Qendrës Kombëtare koordinuese për luftë kundër krimit të organizuar”, në pjesën 3 është paraparë në fushën e reformës së shërbimeve të sigurisë dhe të shërbimeve të zbulimit, ndërsa në pjesën 6 paraqiten në fushën e luftës kundër krimit të organizuar dhe kundër korrupsionit.

## Prioretizimi i masave dhe strukturimi i tyre i mëtejshëm

---

Ekziston përmirëson në planin 6 në raport me prioretizimin, prezantimin dhe formulimin e fushave dhe të aktiviteteve. Në të vërtetë, në raport me fushat prioritare të cilat i përfshin plani, të njëjtat janë prezantuar sipas radhitjes e cila në masë të madhe korrespondon me ndërhyrjet e mëdha reformuese të cilat shteti duhet ti bëjë në drejtim të liritimit të “shtetit të robëruar”, ndërsa të cilat burojnë dhe janë të prioretizuara në raportet e Pribesë dhe Prioritetet urgjente reformuese. Dhe kështu, plani

fillon me fushat “gjqësi”, reforma i shërbimeve të sigurisë dhe të zbulimit” dhe “reforma e administratës publike” – fusha të vlerësuara si kyçe nga UE. Prioretizimi është përmirësuar edhe në raport me vetë aktivitetet në vetë fushat prioritare të cilat janë logjikisht të vendosura dhe i drejtohen njëra-tjetrës, që nuk ndodhte me versionin e parë. Gjithashtu, masat në pjesën 6 janë të formuluar në mënyrë më përkatëse për shkak të të cilës përcaktimi i treguesve u përmirësua në mënyrë të konsiderueshme. Përmirësimi mund të vërehet edhe në faktin që formati i ri i planit parashikon kornizë kohore për përmbushje të masave. Kjo risi është komplementare me vendimin që pjesa 6 të publikohet bashkë me pjesën 9, gjë e cila në mënyrë të konsiderueshme e përmirëson sigurinë dhe parashikueshmërinë e implementimit të tij përmes përkufizimit.

Nga kjo, mund të konkludohet se Qeveria e republikës së Maqedonisë, përmes Sekretariatit për çështje evropiane i ka përkrahur vërejtjet dhe kritikën në raport me prioretizimin e fushave dhe të masave në planin e prezantuar në raportin për pjesën 3. Ashtu siç afrohet periudha e mbylljes së këtij plani të jashtëzakonshëm reformues, institucionet duhet të fillojnë të përgatiten për ristrukturimin e tij, posaçërisht pas paralajmërimit për marrje të rekomandimit të qartë për fillimin e negociatave dhe pas shpalljes së Strategjisë së re për Ballkanin Perëndimor.

Vërejtje në këtë pjesë të prioretizimit të fushave dhe të aktivitetëve është miratimi i Ligjit për gjuhët, edhe krahas asaj se ajo në Planin është fusha e fundit prioritare. Përkundër udhëzimeve të dhëna nga KE dhe udhëheqësit kyç të saj siç është Komisionari për zgjerim dhe politikë të fqinjësisë së mirë<sup>9</sup> se nuk bëhet fjalë për ligj me prioritet evropian, Qeveria e miratoi

---

9 Sanja Seizova - Mërmova, „Han: Ligji për përdorimin e gjuhës shqipe nuk është prioritet evropian,“ Televizioni Sitel, 21-një nëntor, 2017, <http://sitel.com.mk/han-zakonot-za-upotreba-na-albanskiot-jazik-ne-e-evropski-priortet>.

këtë Ligj. Presidenti i shtetit refuzoi ta nënshkruajë dekretin për shpallje të të njëjtit dhe miratimi i tij në të njëjtën kohë shkaktoi reaksion nga opozita me të cilën në mënyrë efektive u bllokua puna e Kuvendit. Ky moment ishte kundër-produktiv në momentin e krijimit të konsensusin nacional, politik dhe shoqëror për zgjidhje të kontestit me emrin dhe për nevojën për miratimin e ligjeve për të cilat duhet shumicë prej 2/3 të anëtarëve të Kuvendit.

## Përfshirje qenësore e palëve të prekura

---

Përmirësimi i vërejtur në zbatimin e aktiviteteve të parapara në planin 3-6-9 është përcjellë me një varg mangësi si për shembull: kyçe sistemore e organizatave civile në procesin e vendimmarrjes, dhe si vijim niveli i ulët i transparencës, mungesa e debatit të informuar publik (shoqëror) dhe arritje e konsensusit esencial politik gjatë miratimit të ndërhyrjeve kyçe reformuese.

Në raport me kyçjen organizatave civile, mund të konkludojmë se në nivel formal, Qeveria vazhdon me praktikën e konsultimeve me palët e prekura si përmes internet-platformës “ENER”, ashtu edhe përmes llojeve të ndryshme të takimeve. Prapëseprapë, diskutimi publik për reformat thelbësore si e asaj për zgjedhje të modelit për ndjekje të komunikimeve të operacionalizuar në AOT, mungonte. Gjegjesisht, modeli u përzgjedh me një vendim të Qeverisë pa diskutim paraprak substancial për zgjedhjen dhe arsyetimin e këtij modeli dhe përputhjen e tij me raportet e Pribes dhe Prioritetet urgjente reformuese. Me iniciativën e Ministrisë së Brendshme, diskutimi për këtë model, si dhe për pakon e ligjeve reformuese në pjesën e sigurisë dhe të inteligjencës, u mbajt pas zgjedhjes së tyre. Ajo

u përqendrua para së gjithash në përmirësimin e propozimeve të qeverisë në pajtim me këtë model, por ato si të tilla nuk u vunë nën pikëpyetje. Për më tepër, në këtë diskutim morën pjesë vetëm një numër i vogël i organizatave të shoqërisë civile, gjë e cila e rrënon transparencën e saj.<sup>10</sup>

Gjithashtu, është vërejtur mungesë e qasjes së uniformuar në përfshirjen e organizatave civile në procesin e vendimmarrjes. Dhe kështu, për dallim nga reformat në sistemin e sigurisë-të zbulimit ku organizatat civile ishin të kyçura në diskutimin publik post factum, diskutimet publike për reformat në media u mbajtën në fazën iniciuese, më saktë para se të miratohen çfarë do qoftë vendime ose politika nga Qeveria. Shembull i tillë janë diskutimet publike për ndryshime të Ligjit për qasje të lirë në informacionet me karakter publik dhe të Ligjit për medime, qëllimi i të cilit ishte përcaktimi i nevojës potenciale për ndryshimin e tyre përmes konsultimeve me palët e involvuara. Pa marrë parasysh që është për ta përhëndetur përfshirja e organizatave civile nga ana e Qeverisë, ajo që mungon që nga fillimi i zbatimit të këtij plani është përfshirja sistemore e organizatave civile në përcjelljen, avancimin dhe promovimin e planit reformues që në mënyrë të konsiderueshme do të kontribuojë për shmangien e situatave të këtij lloji. Duke ju referuar kësaj është e paqartë se përse Qeveria nuk kalon ndaj përfshirjes së këtillë të palëve të prekura dhe ti ndihmojë vetes në procesin e zbatimit të Planit dhe të agjendës evropiane. Nga publikimi i raportit të parë nga monitorimi i zbatimit të planit 3-6-9, Instituti për Demokraci përkrah propozim me të cilin organizatat civile duhet të kyçen në procesin përmes informimit të rregullt (të paktën një herë në muaj) nga ky ad hoc grup i ekspertëve. E njëjta do të kontribuojë ndaj bashkëpunimit më të mirë, përmirësimit të kushteve për

---

10 Nga ana tjetër, në periudhën midis nëntorit dhe dhjetorit të vitit 2018, opinioni kishte mundësi që të njëhej me reformat në fushën e sigurisë përmes disa debateve publike për reformat në sistemin e sigurisë-zbulimit të organizuara nga organizata civile dhe institucione të arsimit të lartë.

ndjekje dhe komentim për ndërhyrjet reformuese në kohë.

## Drejt finalizimit të suksesshëm të Planit

---

Për fund, në krahasim me pjesën 3, do të mund të konkludohej se ekziston përmirësim në pjesën 6 në raport me formulimin e aktiviteteve, si dhe prioretizim dhe strukturim i fushave dhe aktiviteteve me çka, në mënyrë të konsiderueshme është përmirësuar shkalla e matjes së aktiviteteve në planin, por edhe sigurinë dhe shkallën e parashikimit të tij. Si pozitiv mund të vlerësohet edhe fakti që pjesa 6 shënon status më të lartë të realizimit nga pjesa 3 - 52% të përmbushjes së masave në pjesën 6 përballë 41% përmbushjes së masave në pjesën 3.

Nga ana tjetër, mbetet vërejtja se, përkundër përmirësimeve të përmendura më lartë, plani ende përmban aktivitete të cilat nuk paraqesin ndërhyrje reformuese përkatësisht paraqesin kompetencë e resorëve të institucioneve të përfshira me të njëjtin. Gjithashtu, ajo që mungonte në zbatimin e pjesës 6 është transparenca e Qeverisë në kuptim të informimit në kohë të opinionit për statusin e realizimit të masave të përfshira me këtë pjesë. Më tej, edhe përkundër faktit se pjesa më e madhe nga aktivitetet në pjesën 3 vazhdojnë në pjesën 6, që është vazhdimësi e fushave të caktuara (për shembull: Zgjedhjet, Kohabitimi me Presidentin dhe Marrëveshja Kornizë e Ohrit) dhe të masave (rikthehu në kapitullin “Vazhdimësia e planeve të publikuara”) mbetet i paqartë duke pasur parasysh atë që në pjesën 6 nuk janë paraparë qartë ose aspak nuk janë paraparë fushat dhe masat përkatëse. Aq më tepër, gjatë zbatimit të pjesës së aktiviteteve në pjesën 6, mungonte përfshirje thelbësore e organizatave civile (posaçërisht në pjesën e reformave në sigurinë dhe të zbulimit), ndërsa një pjesë e ligjeve reformuese kyçe (para së gjithash në

fushat “gjqësi” dhe “siguri dhe zbulim”) u miratuan ose hynë në procedurë parlamentare në periudhën në të cilën opozita e bojkotonte punën e Kuvendit.

Për këtë arsye, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Sekretariatit për çështje evropiane ju mbetet të sigurojnë se shkalla e realizimit të masave do të jetë edhe më e lartë në pjesën 9. Në raport me mangësitë të lartë përmendura në pjesën 6, dhe në kushte të pjesës 9 veq më të publikuar, ajo në të cilën Qeveria dhe SÇE patjetër duhet të fokusohen është informimi në kohë i opinionit për statusin e realizimit të pjesës 9 dhe përfshirje thelbësore e palëve të prekura në procesin e krijimit dhe të zbatimit të reformave, dhe kjo është në drejtim të kthimit të rekomandimit të pastër për fillimin e bisedave qasëse për anëtarësim në UE.



## Aneks ndaj raportit

---

### Metodologjia sipas së cilës ndiqet implementimi i Planit 3-6-9

Shkalla e përmbushjes së aktiviteteve ndiqet përmes përcaktimit të treguesve vetanak dhe në raste të caktuara edhe të nën-treguesve. Matja e statusit të përmbushjes të aktiviteteve do të zhvillohet sipas logjikës vijuese: 1. E realizuar; 2. Pjesërisht e realizuar (në vazhdë e sipër); 3. E pa realizuar; 4) E pamatshme / nuk mund të përcaktohet. Mënyra e tillë e ndjekjes buron nga vetë natyra dhe mënyra në të cilën janë përcaktuar aktivitetet në Planin.

**E realizuar:** Të përmbushura konsiderohen ato aktivitete treguesit e të cilave vejnë në pah se aktiviteti i paraparë është realizuar në kuadër të afatit të paraparë kohor prej 3 muaj përkatësisht, përfundimisht me zgjedhjet lokale.

**Pjesërisht e realizuar (në vazhdë e sipër):** Për pjesërisht të realizuara konsiderohen ato aktivitete treguesit dhe nën-treguesit e të cilave janë pjesërisht të realizuar; është realizuar vetëm një nga treguesit (në rast se ka më tepër tregues); ose janë realizuar treguesit, por jo edhe nën-treguesit.

**E pa realizuar:** Si të pa realizuara do të konsiderohen ato aktivitete treguesit dhe nën-treguesit e të cilave vejnë në pah se aktiviteti i paraparë nuk është realizuar në kuadër të afatit të paraparë kohor.

Nuk mund të përcaktohet: Për aktivitetet statusi i të cilave të realizimit nuk do të mund të përcaktohet konsiderohen ato aktivitete për të cilat nuk do të ekzistojë burim i besueshëm se janë të realizuara, të pa realizuara, përkatësisht pjesërisht të realizuara; aktivitete që duhet të ri-formulohen për tu përcaktuar tregues; aktivitete të cilat sipas natyrës së vet janë kompetencë e resorit institucionit kompetent, si dhe aktivitete të cilat sipas natyrës së vet nuk janë të matshme.

Gjatë përcaktimit të statuseve të realizimit/përmbushjes për çdonjërin nga aktivitetet ekziston burim, i cili shërben si dëshmi dhe mbështetje se kodifikimi i të njëjtit është realizuar në pajtim me udhëzimet e parapara metodologjike.

## Bibliografi

---

### Burime të shtypura

Grup ekspertësh. “Rekomandime të grupit të ekspertëve për çështjet sistemore të sundimit të të drejtës me përcjellje të komunikimeve të publikuar në pranverë të vitit 2015,” Komisioni Evropian, 8-të qershor, 2015.

Neçev Zoran dhe Nikollovski Ivan, „Gara në 3, 6 dhe 9 me pengesa: Monitorim i zbatimit të tre muajve të parë nga Plani 3-6-9,” Instituti për demokraci „Societas civilis“ - Shkup, nëntor 2017.

### Burime elektronike

360 Shkallë, “2018 - Sa është i rëndësishëm për Maqedoninë, aq sukcesi eventual i Maqedonisë është me rëndësi edhe për Brukselin,” 360 Shkallë, 26-të dhjetor, 2017, [https://www.youtube.com/watch?v=\\_XOIsyc0Rds](https://www.youtube.com/watch?v=_XOIsyc0Rds).

Jovanovska, Svetlana “Han për NOVA: Do t'i japim rekomandim të pastër Maqedonisë,” Nova TV, shkurt 6, 2018, <http://novatv.mk/han-za-nova-ke-i-dademe-chista-preporakana-makedonija/>.

Ministria e drejtësisë, “Fjala e Ministrit të drejtësisë, Bilen Saliji në pres - konferencën e sotme për funksionalitetin e sistemit informatik,” Ministria e drejtësisë, 7-të dhjetor, 2017 [http://www.pravda.gov.mk/novost\\_detail.asp?lang=mak&id=1416](http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1416).

Mukoska - Ivanovska, Elena „Për Karaxhovskin nuk ka asgjë të tmerrshme në raportin për „Akmis-in“, „ Tellma/Televizioni kombëtar, 15-ët shkurt, 2018, <http://telma.com.mk/za-karadhovski-nema-nishto-strashno-vo-izveshtajot-za-akmisot/>.

Seizova - Mërmova, Sanja „Han: Ligji për përdorimin e gjuhës shqipe nuk është prioritet evropian,” Televizioni Sitel, 21-një nëntor, 2017, <http://sitel.com.mk/han-zakonot-za-upotrebanalbananskiot-jazik-ne-e-evropski-priortet>.